

I. ANALIZA E TE ARDHURAVE 2009**TE ARDHURAT TOTALE**

Te ardhurat ne buxhetin e konsoliduar per vitin 2009 jane 298.3 miliarde leke ose 21.6 miliarde me pak se parashikimi per kete periudhe. Krahasur me vitin 2009, kemi një rritje të ët ardhurave totale me rreth 2.4% ndhe një rritje prej 30% krahasuar me vitin 2006.

Të ardhurat tatimore u realizuan në masën 270,6 miliard lek, dhe me një rritje prej 2.3% krahasuar me vitin 2008 dhe 31.7% krahasuar me vitin 2006.

Te ardhurat nga tatimet dhe doganat jane 208.6 miliarde leke, 10.7 miliarde me pak se parashikimi dhe 1.6 perqind me shume se ne vitin 2008 dhe 31.4% me shume se ne vitin 2006; te ardhurat nga taksat vendore jane 12.1 miliarde, 6.2 miliarde me pak se parashikimi dhe 7.4 perqind me te larta se nje vit me pare; te ardhurat ne buxhetet e pavarura jane 49.8 miliarde, 391 milion me pak se parashikimi dhe 4.1 perqind me shume se ne vitin 2008; te ardhurat jo tatimore arrihen ne 24.5 miliarde, me nje mosrealizim prej 900 milion lek ndaj nje viti me pare prej 3 perqind me pak; te ardhurat nga ndihmat jane 3 miliarde leke, 3.2 miliarde me pak se parashikimi dhe 27 perqind me pak se nje vit me pare.

Shperndarja e te ardhurave sipas burimit

Ne vitin 2009, te ardhurat tatimore perbejne 90.7perqind te totalit te te ardhurave ne buxhetin e shtetit, te ardhurat jo tatimore 8.2 perqind,dhe grantet vetem 1.1 perqind te te ardhurave totale.

Ne grupin e madh te te ardhurave tatimore, burimi me i rendesishem jane te ardhurat nga taksimi i mallrave dhe sherbimeve (ndryshe taksimi i konsumit ose indirekt ku perfshihen TVSH dhe akciza), me 53 perqind te totalit te te ardhurave tatimore; te ardhurat nga taksimi i te ardhurave (te individeve dhe bizneseve, ku perfshihen tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi te ardhurat personale) jane ende ne nivel modest per nga rendesia me 16 perqind te te ardhurave tatimore; te ardhurat nga kontributet prodhojne 18 perqind te te ardhurave tatimore; kontribut ende jo te rendesishem ka taksimi i pasurise ne Shqiperi, me vetem 0.64 perqind te te ardhurave tatimore.

Pergjate viteve, taksimi i konsumit e ka rritur rendesine kundrejt taksimit te te ardhurave: nga TVSH dhe akciza merrej rreth 44.3 perqind e te ardhurave tatimore ne vitin 2001, kundrejt 52 perqind te vitit 2009.

Theksojme se norma e TVSH ka mbetur e

pandryshuar per me shume se dhjete vjet; rritja domethenese e te ardhurave nga ky tatim eshte reflektim i rritjes se PBB, ndryshimit te struktures se ekonomise dhe mire administrimit. Te ardhurat nga taksimi i te ardhurave dhe fitimit kane ruajtur pak a shume te njejtin nivel prej 16-17 perqind te te ardhurave tatimore. Ketu ka pasur dy efekte te kunderta mbi te ardhurat: ulja e normave te taksave direkte dhe zgjerimi i bazes se taksueshme. Vlen te permendet se taksimi i kompanive eshte ulur ne menyre domethenese, ndersa te ardhurat nga taksimi individual jane rritur si rezultat i thjeshtimit te sistemit te taksimit dhe masave administrative per uljen e informalitetit. Nuk ka progres te dukshem ne mbledhjen e te ardhurave nga taksimi i pasurise, si rezultat i problemeve te perhershme lidhur me regjistrimin dhe deklarimin e drejte te pasurise se paluajtshme nga individet.

Taksat e tjera sic jane taksat kombetare, disa taksa lokale, taksat mbi tregtine nderkombetare, taksat mbi automjetet dhe disa zera te tjere me pak te rendesishem kane nje pjese me te vogel ne totalin e te ardhurave tatimore, nga 19.8 perqind ne vitin 2001 ne 11.3 perqind ne vitin 2008.


ANALIZA SIPAS TAKSAVE


Tatimet mbi mallrat dhe sherbimet:

Tatimi mbi Vleren e Shtuar

Te ardhurat nga TVSH per 12 mujorin eshte 110.06 miliarde leke, 2.6 miliarde me pak se parashikimi dhe 2.8 perqind me shume se nje vit me pare, nga te cilat rreth 70% jane mbledhur ne import dhe 30% brenda vendit, duke ruajtur te njejtin raport si dhe ne vitin 2008. Krahasur me vitin 2006, verehet nje rritje rreth 48.2% te ketyre te ardhurave. Per periudhen Janar-Dhjetor 2009, administrata doganore mblodhi **77.4 miliarde leke** nga TVSH ne import, ose 2 miliarde leke me pak se parashikimi dhe 3.25 perqind me shume se viti 2008. Keto te ardhura zene rreth 25% te totalit te te ardhurave te buxhetit. Krahasur me vitin 2008 verehet nje rritje e tyre prej 3.3% dhe rreth 50.7% krahasur me vitin 2006.

Ecuria e te ardhurave nga TVSH ne import eshte e lidhur ngushte me ecurine e importeve gjate ketij viti. Per 10 mujorin, nga te dhenat e DPD, vlera e importeve ishte 350 miliarde leke nga 358 miliarde leke te vitit 2008, ose 2.2 perqind me pak. Volumi i importeve per 10 mujorin pati nje rritje prej 15 perqind kundrejt nje viti me pare. Viti 2009 u karakterizua nga nje ulje e cmimeve te produkteve te importit, vecanerisht per artikuj si karburante, hekur ndertimi dhe drithera (shih grafikun me poshte). Ne grafiket me poshte paraqiten importet ne vlere dhe ne volum per tre tremujoret e pare te vitit 2009 dhe krahasimi me 2008.







TVSH brenda vendit arriti ne vleren **32.7** miliarde leke. Ky nivel te ardhurash eshte rreth 2.5 miliarde me i ulet se parashikimi per vitin 2009 dhe 1.65 perqind me i larte se viti 2008 dhe 42.6% krahasuar me vitin 2006.

Te dhenat mbi shperndarjen sektoriale te TVSH¹ tregojne se sektori i industrise ka dhene gjate ketij viti 20 perqind te te ardhurave nga TVSH, ndertimi 36 perqind, sherbimet 31 perqind. Rritja vjetore e te ardhurave nga TVSH ne industri (6 mujorit i pare 2009 kundrejt 6 mujorit te pare te 2008) eshte negative me 24 perqind me pak, ndersa ndertimi, sherbimet dhe transporti kane rritje pozitive te te ardhurave nga TVSH.

Ne grafiket ne vijim pasqyrohet ecuria e te ardhurave nga TVSH ne import dhe brenda vendit dhe krahasimi me 2008.



Tatimi mbi vleren e shtuar




¹ Te dhenat me te fundit nga DPT i referohen 6 mujorit te pare 2009

Tatimet mbi mallrat dhe shërbimet: Akcizat


Te ardhurat nga akciza arriten ne nivelin 32,510 milion leke nga 35,493 milion te parashikuara per periudhen dhe 41% më shumë se në vitin 2006. Nga te ardhurat e akcizes per 2009, rreth 64.3% janë mbledhur në import dhe 35.7% brenda vendit.

Të ardhurat nga akciza brenda vendit arritën në shifrën 11,6 miliard lek nga 13 miliard lek të parashikuara per 2009 dhe 3.1% ose 1.8 miliard lek më shumë se në 2008, ose me një realizim prej 89.4%. Sipas mallrave të akcizës brenda vendit, të ardhurat më të larta janë mbledhur nga akciza nga cigaret të cilat zënë rreth 64% të totalit, 5.3% nga pijet alkoolike 22.7% nga karburanti vendas.

- Të ardhurat nga akciza në import arritën në shifrën 20 miliard lek ose 93% e realizimit të parashikimit.



Akcizat



Tatimet mbi tregtine nderkombetare: taksa doganore

Ka vazhduar tendeca renese, sipas parashikimeve e te ardhurave nga taksa doganore. Per periudhen Janar-Dhjetor te ardhurat nga taksa doganore arriten ne 7.9 miliarde leke ose 92 milione leke me shume se plani dhe 8.4 perqind me pak se nje vit me pare. Per 2009, tarifa mesatare doganore (not weighted average) ishte 2 perqind. Gjate ketij viti vijuan


reduktimet tarifore nga zbatimi i marreveshjes se tregtise se lire me vendet CEFTA dhe me Bashkimin European.

Tatimet mbi te ardhurat dhe fitimin: tatimi mbi te ardhurat personale

Eshte tatimi me i rendesishem i taksimit direkt ne Shqiperi. Ne mesin e vitit 2007 struktura e tatimit (mbi pagat) ndryshoi nga progresive ne proporcionale, me norme unike taksimi 10 perqind mbi te gjitha llojet e te ardhurave individuale.

Per periudhen Janar-Dhjetor 2009, te ardhurat nga TAP arriten ne 26.8 miliarde leke nga 29.6 te parashikuara ne buxhetin e rishikuar 2009 dhe 2.3 miliarde me shume se viti 2008ose me nje rritje 9.5% krahasur me vitin 2008 dhe 212.6% krahasur me vitin 2009.

Burimi kryesor i te ardhurave nga TAP eshte tatimi mbi pagen (sektor publik dhe privat), qe perben 55.4 perqind te te ardhurave gjithsej nga ky tatim. Ne vlere absolute keto te ardhura ishin 15 miliarde. Rritja vjetore e tatimit mbi pagen ne sektorin publik ishte 12.6 perqind ndersa ajo e tatimit mbi pagen ne sektorin jo publik ishte 13.6 perqind. Megjithate kjo rritje eshte me pak e theksuar se ne muajt e pare te vitit 2009, sic shihet dhe nga grafiku.



	% e rritjes ndaj 2008
TAP sipas zerave	
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	10%
Nga te punesuarit e Sherbimit Publik (Shteteror)	13%
Nga te punesuarit e Sherbimit jo Publik	14%
Tatimi mbi te Ardhurat nga Interesat	24%
Tatimi mbi te Ardhurat nga Qerate	13%
Tatim mbi te ardhurat personale te b.v.2-8 mln	
Te tjera Tatime mbi te Ardhurat mbajtur ne Burim	27%
Tatimi mbi te Ardhurat nga Devidentet dhe Aksionet	-41%
Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe pronesis Intelktuale	85%
Tatimi mbi shitjen e Pasurise se Palujtshme (nga individet)	-18%

Te ardhurat nga tatimi mbi interesat ishin 3 miliarde leke, me rritje pozitive kundrejt vitit 2008 prej 24.1 perqind; te ardhurat nga tatimi mbi shitjen e pasurise se paluajtshme arriten ne 2.2 miliarde leke, me rritje negative kundrejt vitit 2008 prej -18.9 perqind. Ndryshimi i menyres se taksimit te shitjes e pronesise se patundshme ne vitin 2008 solli impaktet e veta pozitive ne buxhetin e2008, ndersa ne vitin 2009 verehet nje ulje e ketyre te ardhurave e cila ehste e lidhur ngushtesit me zhvillimet ne sektorin te ndertimit dhe tregun e shitblerjes se pasurise se patundshme.

Nga te dhenat paraprake te DPT lidhur me numrin e kontribuesve te tatimit mbi te ardhurat personale, qe i referohen gjashtemujorit te pare te 2009, rezulton rritje e numrit te taksapaguesve ne 367,530 nga 354,410 te gjashtemujorit te pare te vitit 2008, te ndare ne kater kategori: administrate publike 123,707 kontribues, ndermarrje publike 25,921 kontribues, sektor privat (me xhiro vjetore me shume se 8 milion leke) 154,697 kontribues, biznes i vogel (me xhiro vjetore me pak se 8 milion leke) 63,048 kontribues. Nga krahasimi i te dhenave me vitin 2008, vihet re kalimi i nje pjese te kontribuesve nga sektori i ndermarrjeve publike ne sektorin privat si rezultat i privatizimeve. Ne 2009 sektori privat ka 21,403 kontribues me shume se nje vit me pare, tregues ky i rritejs se formalizmit te tregut te punes si rezultat i politikes fiskale te ulejs se normes se kontributeve ne maj 2009 Nderkohe, sipas sektoreve te ekonomise, ka nje rritje te taksapaguesve te TAP ne sektorin e sherbimit me 6 perqind dhe ne sektorin e tregtise me 15 perqind, ndersa industria dhe ndertimi kane pakesuar perqindjen e tyre ne numrin total te kontribuesve te tatimit mbi pagen.

Tre te katertat e te ardhurave gjithsej nga tatimi mbi te ardhurat personale vjen nga sektori i sherbimit, 11 perqind nga tregtia, dhe pjesa tjeter nga sektoret e tjere te ekonomise. Rritja vjetore e te ardhurave nga TAP ne sektorin e sherbimeve shenoi 87 perqind per tremujorin e dyte 2009, ndersa te ardhurat nga TAP ne tregti dhe industri paten rritje vjetore negative prej 18 dhe 27 perqind.² Ne kete ze perfshihen edhe te ardhurat personale te bizneist te vogel, tatim ky i prezantuar ne vitin 2008 dhe qe zba6timin e pare te tij e pati ne mars te vitit 2009. Sipas te dhenave te DPT rezultoi se se keto te ardhura arriten ne vleren 139.3 milion lek.

Tatimet mbi te ardhurat dhe fitimin: tatimet mbi te ardhurat e biznesit


Perfshihen tatimi mbi fitimin dhe taksa vendore mbi biznesin e vogel. Te ardhurat nga ky grup tatimesh perbejne 7.2 perqind te te ardhurave tatimore. Per 12 mujorin ato arriten ne 19.7 miliarde, ose rreth 1 miliarde leke me pak se nje vit me pare, te ndara ne: tatimi mbi fitimin 17.2 miliarde leke nga 18.1 te nje viti me pare; taksa mbi biznesin e vogel 2.5 nga 2.6 miliarde te nje viti me pare. Kundrejt parashikimit ne buxhetin e rishikuar te 2009, tatim fitimi ka realizuar planin e te ardhurave ne masen 97.7%, ndersa taksa vendore mbi xhiron e biznesit te vogel ka nje diference prej 1 miliarde leke.

Veme ne dukje se ne buxhetin e rishikuar te 2009, te ardhurat e parashikuara nga tatimi mbi fitimin u pakesuan me rreth 3.5 miliarde leke, kryesisht si rezultat i veshtiresive financiare te biznesit ne disa sektore te ekonomise gjate 2009. Per pasoje, parapagimet e tatim fitimit kane qene me te uleta se parashikimi per kete vit. Sektori publik e ka

² Vleresime te DPT per gjashtemujorin e pare te 2009.

pakesuar me tej pjesen e tij ne totalin e te ardhurave nga tatim fitimi, me vetem 2.6 perqind.

Nga te dhenat paraprake te DPT lidhur me shperndarjen sektoriale te tatim fitimit, veme ne dukje disa fakte: te ardhurat e mbledhura nga ndermarrjet ne sektoret e ndertimit dhe te sherbimeve perbejne pjesen dermuese te te ardhurave nga tatim fitimi, me rreth 65 perqind (perkatesisht 27 dhe 37 perqind te totalit te TF). Megjithate, rritja vjetore e te ardhurave nga TF ne sherbime (6M 2009/6M 2008) eshte negative, ne masen -12 perqind. Rritje vjetore negative ka patur dhe TF nga sektori i tregtise dhe industrise.



Taksimi i pasurise

Per qellim analize, ketu kemi perfshire: tatimin mbi ndertesat, mbi token bujqesore dhe taksen e kalimit te pasurise (te treja taksa lokale).

Sic e theksuam dhe me lart, taksimi i pasurise eshte i paperfillshem per nga te ardhurat qe mbledh ne Shqiperi, krahasuar me ekonomite e zhvilluara. Per periudhen Janar- Dhjetor te ardhurat nga taksimi i pasurise jane 2.2 miliarde leke nga rreth 2.7 miliarde leke te nje viti me pare. Veshitesite ne mbledhjen e te ardhurave potenciale nga ky grup taksash lidhen kryesisht me probleme te administrimit tatimor ne nivel lokal, si dhe me bazen e ngushte tatimore.

Te tjera taksa mbi mallra dhe sherbime

Ne kete grup jane **taksat nacionale**, dhe per periudhen Janar-Dhjetor jane mbledhur rreth 13.8 miliarde leke, ose 1.3 miliard lek me pak, me nje ulje 8.6 perqind ndaj vitit 2008 dhe nje ritje modeste 1.4 perqind krahasuar kjo me vitin 2006. Veme ne dukje se viti 2009 ishte viti i pare i plote i zbatimit te ligjit te ri te taksave nacionale, qe u reduktuan ne mesin e 2008 ne vetem 7 te tilla. Ne kete kuader, ndryshime thelbesore pesoi dhe renta minerare, per te cilen gjate 2009 mblodhi rreth 893 milion leke nga administrata doganore dhe 694 milion lek nga administrata tatimore.

Kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore

Te ardhurat nga kontributet perbejne 18.2 perqind te te ardhurave tatimore. Per periudhen janar-dhjetor 2009 ato arriten ne 49.8 miliarde leke me nje diference prej 391 milion leke me pak se parashikimit dhe me rritje 4.16 perqind ndaj nje viti me pare. Gjate vitit 2009, pati nje ulje te normes kontribuese te punedhenesit prej 5 pike perqindje, me efekt nga 1 Maji 2009, e cila siaps te ardhurave te realizaur verehet se nuk arriti te jepete efektin e plote pozitiv.

TE ARDHURAT NGA PUSHTETI LOKAL

Per periudhen Janar-Dhjetor te ardhurat tatimore te pushtetit lokal arriten ne 12.15 miliarde leke, 6.3 miliarde me pak se parashikimi dhe 7.4 perqind me shume se nje vit me pare. Taksimi mbi pasurise (ndertesat perben 12.4 perqind te totalit; taksa vendore e

biznesit te vogel 20.5 perqind te totalit te te ardhurave lokale dhe Taksa Lokale perben 67.1 percind te te ardhurave nga pushteti lokal. Rritjen me te madhe vjetore e paten te ardhurat nga taksat e tjera lokale, prej 14.24 perqind ndaj 2008. Kontribuesi kryesor ne kete grup eshte taksa e infrastruktures mbi ndertimet e reja. Te ardhurat nga ky ze u rriten me 55 perqind ndaj nje viti me pare.

Te dhenat mbi shperndarjen gjeografike te te ardhurave nga taksat lokale, tregojne se gati e gjysma e tyre mblidhet ne qarkun e Tiranes; 11 perqind ne qarkun e Durresit; 10 perqind ne qarkun e Vlores.


Te ardhurat e mbledhura nga taksat lokale jane dukshem nen nivelin potencial te tyre, pasoje e veshtiresive ne administrimin dhe mbledhjen e taksave mbi pasurine dhe biznesin e vogel. Te ardhurat nga biznesi i vogel u ndikuan negativisht dhe nga ngadalesimi i pergjithshem i aktivitetit ekonomik gjate 2009.

TE ARDHURAT JOTATIMORE

Perbejne rreth 8 perqind te te ardhurave totale buxhetore, Per periudhen janar-dhjetor u mblodhen rreth 24.5 miliarde leke, me nje rritje kundrejt vitit 2008 prej 8.8 perqind dhe 54.6 perqind kundrejt vitit 2006.

ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PER VITIN 2009.


Shpenzimet e pergjithshme te buxhetit, ne fund te vitit 2009, arriten ne rreth 376.8 miliarde leke, nga rreth 401.5 miliarde leke te parashikuara sipas aktit normativ, duke u realizuar ne rreth 93.9 perqind ose me nje mosrealizim prej rreth 24.7 miliarde leke. Ne kete menyre keto shpenzime ne fund te vitit 2009 arriten ne rreth 32.96 perqind e Produktit te Brendeshem Bruto, nga rreth 32.38 perqind qe arriten nje vit me pare. Kundrejt vitit 2008, shpenzimet buxhetore rezultojne rreth 25.3 miliarde leke me te larta, ose rreth 7.2 perqind me shume.



Shpenzimet korente, kane arritur ne rreth 282.5 miliarde leke ose rreth 98.8 perqind te planit sipas aktit normativ, duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 3.5 miliarde leke. Por duke mbajtur ne konsiderate perdorimet e fondit rezerve te buxhetit te shtetit, perdorimet e fondit te kontigjences per rritjen e pagave dhe pensioneve, perdorimin e fondit te kontigjences per ruajtjen e deficitit si dhe rishperndarjet e fondeve buxhetore ndermjet ministrive dhe institucioneve, plani i shpenzimeve korente per vitin 2009 eshte realizuar ne rreth 95.4 perqind ose rreth 13.8 miliarde leke me pak se **ky plan i ndryshuar**.


Shpenzimet korente arriten ne rreth 24.7 perqind te PBB-se nga rreth 23.1 perqind qe ishin nje vit me pare.

Krahasuar me vitin e kaluar, keto shpenzime rezultojne rreth 32.2 miliarde leke me te larta ose rreth 12.9 perqind me shume.




Brenda shpenzimeve korente, **shpenzimet e personelit**, qe perfaqesojne rreth 22.1 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate vitit 2009, rezultojne me nje kursim prej rreth 1.8 miliarde leke ose rreth 2.9 perqind me pak se plani i ndryshuar, rrjedhoje kjo e kursimeve ne zerin shpenzime per paga.

Shpenzimet e personelit ne fund te vitit 2009 arriten ne rreth 5.45 perqind e PBB-se nga rreth 6.14 perqind qe ishte nje vit me pare.




Krahasuar me nje vit me pare, shpenzimet e personelit rezultojne rreth 4.3 miliarde leke me te ulta, ose rreth 6.4 perqind me pak, nderkohe qe shpenzimet per paga rezultojne rreth 2.7 miliarde leke me te ulta, ose rreth 4.8 perqind me pak dhe shpenzimet per kontribute te sigurimeve shoqerore rreth 1.5 miliarde leke me te ulta, ose rreth 14.6 perqind me pak.

Gjate vitit 2009 nje fond prej rreth 3.7 miliarde leke ishte planifikuar per rritjen e pagave, rritje qe u parashikua qe ne muajin maj, ndryshe nga vitet e tjera qe kjo rritje pagash ishte planifikuar ne gjashtemujorin e dyte te vitit. Nga ky fond rreth 3.7 miliarde leke, 3 miliarde leke ishte planifikuar per rritjen e fondit te pagave te ministrive dhe institucioneve buxhetore dhe 0.7 miliarde leke per kontributin e sigurimeve shoqerore.




Shpenzimet per interesa, qe perfaqesojne rreth 12.8 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate vitit 2009, krahasuar me planin e ndryshuar rezultojne me nje kursim prej rreth 125 milione leke, kursim ky i evidentuar ne interesat e brendeshme me rreth 12 milione leke dhe ne interesat e jashtme, me rreth 113 milione leke. Ne kete menyre shpenzimet per interesa arriten ne rreth 3.65 per qind e PBB-se nga rreth 3.15 perqind qe ishin nje vit me pare.

Kundrejt vitit te kaluar shpenzimet per interesa rezultojne rreth 5.0 miliarde leke me te larta ose rreth 15.95 perqind me shume, rrjedhoje kjo e interesave te brendeshme te cilat rezultojne rreth 3.0 miliarde leke me te larta se nje vit me pare dhe e interesave te jashtme qe jane rreth 2 miliarde leke me te larta.




Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes gjate vitit 2009 arriten ne rreth 30.8 miliarde leke duke qene rreth 5.0 miliarde leke nen nivelet e planit te ndryshuar, ose rreth 13.9 perqind me pak. Krahasuar vitin e kaluar ato rezultojne rreth 2.0 miliarde leke me shume ose rreth 7.1 perqind me te larta. Keto shpenzime ne fund te vitit 2009 arriten ne rreth 2.7 perqind te PBB-se nga rreth 2.65 qe ishin nje vit me pare.




Shpenzimet per subvencione ne fund te vitit 2009, rezultojne ne rreth 98.9 perqind te planifikimit vjetor ose rreth 22 milione leke me pak se ky planifikim. Kundrejt nje viti me pare keto shpenzime rezultojne rreth 551 milione leke me te ulta ose rreth 21.6


perqind me pak. Subvencionet ne vitin 2009 arriten ne rreth 0.18 perqind te PBB-se, nga rreth 0.24 perqind qe rezultuan nje vit me pare, rrjedhoje kjo e politikes gjithnje ne ulje te ketyre shpenzimeve.



Shpenzimet per sigurimet gjate vitit 2009, rezultojne rreth 97.02 perqind e planit te ndryshuar. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit prej rreth 1.7 miliardë leke të shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe e mosrealizimit me rreth 1.2 miliardë leke të shpenzimeve për sigurimet shëndetësore. Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 7.9 miliardë leke me të larta ose rreth 12.0 perqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 12.6 miliardë leke me të larta ose rreth 1.2 here më të larta, duke bërë që shpenzimet për sigurimet në total të rezultojnë rreth 20.5 miliardë leke me të larta ose rreth 26.9 perqind më shumë se viti i kaluar.




Shpenzimet per buxhetin lokal kanë arritur në rreth 32.8 miliardë leke nga rreth 36.8 miliardë leke të planifikuara për vitin 2009, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth 4.0 miliardë leke ose rreth 10.8 perqind më pak se plani i periudhës. Krahasuar me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 5.8 miliardë leke më të larta ose rreth 21.3 perqind më shumë. Këto shpenzime arrijnë në rreth 2.87 perqind të PBB-së nga rreth 2.49 perqind që rezultoi vitin e kaluar.



Pagesa e papunesise rezulton me nje mosrealizim prej rreth 1.9 perqind ose rreth 17 milione leke me pak se parashikimi vjetor, duke qene ne te njejten kohe rreth 43 milione leke me shume ose rreth 5.2 perqind me shume se nje vit me pare.

Ndihma ekonomike gjate vitit 2009 arriti ne rreth 16.7 miliarde leke, duke qene ne te njejten kohe rreth 738 milione leke me shume ose rreth 4.6 perqind me e larte se nje vit me pare. Nje fond prej rreth 1.4 miliarde leke u planifikua ne fund te vitit per dhenie asistence ekonomike te menjehereshme personave qe perfitojne pension.




Deri ne fund te vitit 2009, rreth 1.7 miliarde leke jane perdorur **per kompensimin ne vlere te pronareve**. Kjo shume perfaqeson rreth 98.2 perqind te parashikimit vjetor, ose rreth 31 milione leke me pak planifikimi sipas aktit normativ.


Po keshtu rreth 2.2 miliarde leke ose rreth 69.4 perqind e parashikimit vjetor jane perdorur per kompensimin e ish te perndjekurve politike, me nje diference prej rreth 970 milione leke, duke rezultuar ne te njejten kohe rreth 120 perqind me te larta krahasuar me nje vit me pare ose rreth 1.2 miliarde leke me shume.

Shpenzimet kapitale ne fund te vitit 2009 jane realizuar ne nivelin 89.6 perqind te planit vjetor te ndryshuar, duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 10.9 miliarde leke. Per rrjedhoje investimet ne vitin 2009 arriten ne rreth 8.24 perqind e PBB-se nga rreth 8.64 perqind qe rezultua nje vit me pare.

Brenda ketyre shpenzimeve, investimet me financim te brendeshem jane realizuar ne rreth 92.9 perqind, pra me nje mosrealizim prej rreth 5.8 miliarde leke, nderkohe qe investimet me financim te huaj jane realizuar ne masen 77.6 perqind te planit vjetor me ndryshime, duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 5.1 miliarde leke.



Krahasuar me vitin e kaluar investimet e brendeshme rezultojne rreth 26.6 miliarde leke me te larta ose rreth 53.1 perqind me shume, nderkohe qe investimet me financim te jashtem rezultojne rreth 26 miliarde leke me te ulta, ose rreth 59.7 perqind me pak. Per rrjedhoje investimet ne total ne fund te vitit 2009 jane rreth 410 milione leke me te larta se nje vit me pare, ose rreth 0.44 perqind me shume.



ANALIZE E BUXHETIT TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR VITIN 2009

Për vitin 2009, njësite e qeverisjes vendore ne shkalle kombëtare kane mbledhur **12,149 milion leke**, nga **18,412 milion leke** qe ishte plani. Pra janë mbledhur **6,263 milion leke** me pake se plani ose realizimi i te ardhurave në shifër relative është **66%**.

Te ardhurat tatimore janë realizuar:

- a) **2,486 milion leke** nga taksa mbi biznesin e vogël,



- b) **1,509 milion leke** nga taksa mbi pasurinë,
- c) **8.154 milion leke** nga taksa e tarifa te tjera lokale.

Shpenzimet e kryera nga njësite e qeverisjes vendore për vitin 2009, janë **32,848 milion leke**, nga **36,835 milion leke** qe ishte plani, ose janë kryer **3,987 milion leke** shpenzime me pak se sa ishin planifikuar për vitin 2009, ose janë realizuar ne masën **89.2%**.

Shuma e shpenzimeve prej **32,848 milion leke** e kryer gjate vitit 2009 është shpenzuar për:

- a) Shpenzime korrente **19,218 milion leke** apo **58.5%** e totalit te shpenzimeve, nga te cilat **10,111 milion leke** shpenzime personeli.
- b) Shpenzime për investime **13,630 milion leke** apo **41.5%** e totalit te shpenzimeve, nga te cilat **75 milion leke** janë investime te huaja.


Realizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2009, sipas tremujoreve, është sipas grafikeve te mëposhtëm:



Siç shihet edhe nga grafiket, te ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar kryesisht ne tremujorin e trete dhe te katërt.


Te ardhurat e realizuara ne buxhetin e vitit 2009, janë **42 mije leke** me shume se ato te realizuara ne vitin 2008, ose ne shifër relative **7 %** me shume se sa ne vitin 2008. .

Shpenzimet e kryera ne vitin 2009, janë **5,769 milion leke** me shume se ato te buxhetit te vitit 2008, ose ne shifër relative **21%** me shumë se sa ne vitin 2008.




Zërat kryesore te ardhurave janë: Taksa mbi Biznesin e Vogël, Taksa mbi Pasurinë dhe Taksa te tjerë vendor.

- Taksa mbi biznesin e vogël për vitin 2009, është mbledhur ne masën **2,486 milion leke**, e cila është **98 mije leke** me pak se vlera e mbledhur për te njëjtën takse ne vitin 2008, ose për vitin 2009 është mbledhur **96%** e vlerës se mbledhur ne vitin 2008.
- Taksa mbi pasurinë për vitin 2009, është mbledhur ne masën **1,509 milion leke**, ose **77 mije leke** me pak se vlera e mbledhur për te njëjtën takes ne vitin 2008, ose **95%** e vlerës se mbledhur ne vitin 2008.
- Taksat dhe tarifat e tjera vendore, për vitin 2009, janë mbledhur ne masën **8,154 milion leke**, ose **1,017 mije leke** me shume se sa vlera e mbledhur per te njëjtat taksa ne vitin 2008, ose **114%** e vlerës se mbledhur ne vitin 2008.



Krahasimi 2006-2009



Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore ne vlera absolute nga viti 2006 dhe na vazhdim janë rritur.

Ecuria e Borxhit Publik, Viti 2009 dhe krahasimi 2006-2009

Ndryshimi stokut dhe raportit te tij me PBB-ne


Stoku i borxhit publik ne fund te vitit 2009 arriti ne 59.63% e PBB. Ne perberjen e ketij stoku perfshihen borxhi me instrumenta financiare (i brendshem) 36.30% e PBB dhe borxhi i jashtem 23.33% e PBB.

(ne milione leke)

	2006	2007	2008	2009
Stoku Borxhit Gjithsej	494,668	516,934	595,799	681,849
Stoku Borxhit	348,935	369,536	400,456	415,028

Brendshem				
Stoku Borxhit Jashtem	145,733	147,398	195,343	266,821
PBB	882,209	966,651	1,087,867	1,143,373
Stoku Borxhit				
Gjithsej/PBB	56.07%	53.48%	54.77%	59.63%
Stoku i Borxhit				
Brendshem/PBB	39.55%	38.23%	36.81%	36.30%
Stoku Borxhit				
Jashtem/PBB	16.52%	15.25%	17.96%	23.33%


Siç shihet raporti i stokut të borxhit me PBB ka pësuar rritje si rezultat i rritjes së huamarrjes për plotësimin e nevojave të buxhetit (për shpenzime kapitale). Veçanërisht rritje ka pësuar stoku i borxhit të jashtëm, si rezultat i kredive tregtare të marra gjatë vitit 2009. Përveç këtyre faktorëve, në stokun e borxhit të jashtëm në fund të vitit 2009 ndikon edhe zhvlerësimi i lekut kundrejt Euro-s në masën 11.43% kundrejt fundit të vitit 2008.



Evoluimi i strukture së stokut të borxhit


Gjatë periudhës 2006 – 2009 ka evoluuar edhe struktura e borxhit publik. Në fund të vitit 2006, borxhi i brendshëm përfaqëson 70.5% të stokut të borxhit gjithsej, ndërkohë që në fund të vitit 2009 ai përfaqëson 60.9% të tij. Gjithashtu, është rritur pesha e borxhit të jashtëm nga 29.5% në fund të vitit 2006, në 39.1% të stokut të borxhit gjithsej në fund të vitit 2009.

Ndryshime ka pësuar edhe struktura e borxhit të brendshëm sipas instrumentave. Si rezultat i politikës së ndjekur nga Ministria e Financave në drejtim të emetimit të borxhit, pesha e instrumentave afatgjatë ka ardhur në rritje nga një vit në tjetrin, gjë që përben një zhvillim pozitiv (pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm). Ben përjashtim viti 2009, gjatë të cilit tregu financiar i letrave me vlerë ka qenë tepër i rrishtuar nga situata e krizës financiare, gjë e cila është reflektuar në rritjen e “yield”-eve të letrave me vlerë. Për këto arsye nuk ka qenë e thjeshtë që të hidhen në treg instrumenta afatgjatë pasi vete tregu ka preferuar të investojë tek instrumentat afatshkurter.




Edhe struktura e mbajtesve te borxhit te brendshem ka pesuar *ndryshime pozitive*. Me konkretisht, ka ardhur ne renie pesha e mbajtesit kryesor (RZB Bank), dhe ka ardhur ne rritje pesha e bankave te tjera dhe e kategorise se individeve.

	2006	2007	2008	2009
BOA	19.52%	18.49%	17.75%	17.66%
Raiffeisen Bank	38.53%	35.19%	36.88%	34.57%
Banka te tjera	32.94%	36.73%	34.58%	34.33%
Jo Banka	2.00%	1.92%	2.46%	2.68%
Individe	7.01%	7.67%	8.33%	10.76%




Sa i perket borxhit te jashtem, ne fund te 2009-s stoku i tij arriti 266,82 miliard leke, i ndare ne *borxh te jashtem shteteror* prej 226.54 miliard leke dhe *borxh te jashtem te garantuar* 40.28 miliard leke. Borxhi i jashtem ka pesuar rritje jo vetem si rezultat i shteses se kredise sindikale prej 192.6 milion EUR, por edhe *si rezultat i ecurise pozitive te disbursimeve per projektet me financim te huaj*. Ky eshte nje tregues pozitiv i permiresimit te menaxhimit ne zbatimin e projekteve te huaja, duke çuar ne rritjen e performances se realizimit dhe *uljen e kostos se tyre efektive*.


Stoku i borxhit te jashtem i ndare sipas koncesionalitetit ka pesuar ndryshime ne drejtim te rritjes se kredive te nenshkruara me terma jokoncesionale per financimin e projekteve me rendesi strategjike. Tashme Shqiperia kualifikohet si nje vend me te ardhura mesatare, çka ka sjelle si pasoje edhe *uljen e nivelit te koncesionalitetit te kredive te huaja*. Si rezultat, kane ndryshuar kushtet e marreveshjeve te kredive dhe te tregut te huamarrjes se jashtme ne pergjithesi. Ne fund te vitit 2009, borxhi me terma koncesionale perfaqeson 53.3% te stokut te borxhit te jashtem, kundrejt 79.1% qe perfaqesonte ne fund te vitit 2006.



Lidhur me strukturen e stokut te borxhit te jashtem sipas normes se interesit, borxhi me interes fiks perfaqeson pjesen me te madhe te borxhit te jashtem (grafiku me poshte). Nderkohe pesha e borxhit te jashtem me *interes variabel ka ardhur duke u rritur ne vite*, me nje rritje me te madhe ne vitet 2008, 2009 per arsye te rritjes se huamarrjes me kushte tregtare.



Ne analizen e borxhit te jashtem sipas monedhave vihet re se dy monedhat kryesore ne borxhin e jashtem jane EUR dhe SDR, te cilat ne 2009 perfaqesojne perkatesisht 54.6% dhe 31.76% te totalit te borxhit te jashtem. Megjithate perqindja e borxhit te jashtem ne SDR ka ardhur duke rrene nga viti 2006 e ne vazhdim si rezultat i uljes se huamarrjes nga IDA, ndersa ka ardhur duke u rritur borxhi i jashtem ne EUR, nga 32.08% te stokut te borxhit te jashtem ne fund te vitit 2006, ne 54.6% ne fund te vitit 2009. Ky fakt e ben stokun e borxhit te jashtem me te ndjeshem ndaj ndryshimeve te kursit te kembimit Leke/EURO, duke dhene efekte te ndjeshme ne rivleresimin e stokut te borxhit te jashtem ne fund te vitit 2009.



Ecuria e koston se sherbimit te borxhit

Ecuria e shpenzimeve per sherbimin e borxhit, jepet ne tabelen e meposhtme. Siç vihet re, shpenzimet per shlyerjen e borxhit kane ardhur ne rritje.

	2006	2007	2008	2009
Shpenzimet e Borxhit Gjithsej	29,596	29,693	35,555	42,061
Interesa	25,006	25,595	31,307	36,301
-Interesat e B.Brendshem	22,978	23,499	28,386	31,408
-Interesat e B.Jashtem	2,028	2,096	2,921	4,893
Principali	4,590	4,098	4,248	5,760
PBB	882,209	966,651	1,087,867	1,143,373
Shpenzimet e Borxhit Gjithsej/PBB	3.35%	3.07%	3.27%	3.68%
Interesat /PBB	2.83%	2.65%	2.88%	3.17%
Principal B.Jashtem /PBB	0.52%	0.42%	0.39%	0.51%

Veçanerisht me ritme të larta janë rritur *shpenzimet për interesat e borxhit të jashtëm*, të cilat në vitin 2009 janë rritur me 67.5% në krahasim me vitin 2008, si rezultat i huamarrjes me terma tregtare. Një rritje prej 10.7% kanë pasur edhe shpenzimet për interesat të borxhit të brendshëm, si rezultat i rritjes së normave të interesit të huamarrjes vendase, trend që filloi që filloi në fund të 2008 dhe vazhdoi edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Raporti i shërbimit të borxhit me PBB nga 3.35% e PBB në vitin 2006, arriti në 3.65% në fund të vitit 2009.